



GOETHE-ZENTRUM Prishtina

Kushtet e përgjithshme - Provimet në Kosovë

1. Vlejnë Rregullorja e provimit si dhe kushtet e zbatimit të

provimeve të Goethe Institutit (www.goethe.de/pruefungen)

- 1.1 Provimet duhet të kryhen të plota (me përjashtim të provimeve B1). Të gjithë pjesëmarrësit e provimeve janë të obliguar, që gjatë paraqitjes, para provimit me shkrim dhe me gojë si dhe gjatë terheqjes së dëftesës të paraqiten me pasaport valide.
- 1.2 Në rast të tërheqjes nga provimi apo përjashtimit pagesa e provimit nuk mund të kthehet. Nëse pjesëmarrësi i provimit nuk merr pjesë në provimin me shkrim apo me gojë apo paraqitet me vonesë në vendin e provimit, atëherë nuk kthehet pagesa e bërë për provim. Nuk publikohet rezultat.
- 1.3 Në rast të dëshirës për të hyre në një afat më të vonshëm në provim, atëherë duhet që më së voni dy javë para terminit të provimit të ipet një arsye bindëse me shkrim, përse nuk mund të paraqitet në provim. Në rast se pranohet arsyetimi, atëherë shuma e paguar bartet në një termin më të vonshëm të provimit. Kësaj i shtohet një pagesë administrative prej 40,00 €.Termini i mëvonshëm do të caktohet nga Goethe-Zentrum Prishtina sipas kapaciteteve dhe pjesëmarrësi/ pjesëmarrësja në provim do të informohet. Një garancion për të i'u nënshtruar provimit në vijim nuk ekziston. Në rast se një provim nuk fillohet në ditën e provimit apo ndërpritet pasi që është filluar dhe për këtë ipen arsye shëndetësore, atëherë duhet që brenda 2 ditëve të punës të i parashtrohet Qendrës së Provimeve një atest mjekësor nga mjeku zyrtar përgjegjës. Vetëm atëherë mund të bartet shuma e paguar në një termin tjetër. Kësaj i shtohet një pagesë administrative prej 40,00€.Termini i mëvonshëm do të caktohet nga Goethe-Zentrum Prishtina sipas kapaciteteve dhe pjesëmarrësi/ pjesëmarrësja në provim do të informohet. Një garancion për të i'u nënshtruar provimit në vijim nuk ekziston.
- 1.4 Pjesëmarrësi në provim deklaron se është i pajtimit, që të dhënat e tij të regjistrohen nga Goethe-Zentrum Prishtina në mënyrë elektronike për të bërë një implementim të rregullt të procedurave të regjistrimit, të pagesës si dhe të dëshmisë se njohurive të tij. Pjesëmarrësi në provim gjithashtu deklaron se është i pajtimit që të dhënat rreth



personit të tij, të dhënat mbi pjesëmarrjen në provime si dhe rezultatet e provimeve të i përcjellën Ambasadës Gjermane në Prishtinë si dhe Institucioneve përgjegjëse për Visa, Institucioneve dhe Përfaqësive në Gjermani, Austri dhe Zvicër.

- 1.5 Pjesëmarrësit/Pjesëmarrëses në provim i bëhet e ditur, dhe ai/ajo pajtohet që gjatë provimit me shkrim do të jetë nën vëzhgim të kamerave.
- 1.6 Pjesëmarrësi/ Pjesëmarrësja pajtohet, që performanca e tyre në pjesën e provimit me gojë, të regjistrohet nga Goethe-Zentrum.
- 1.7 Për Pjesëmarrës në provime me nevoja të veçanta ekziston mundësia, që në bazë të një kërkesë të i nënshtrohen provimit nën kushte të veçanta . Ju lutem informohuni për këtë para paraqitjes së provimit në Qendrën për Provime.
- 1.8 Në rast të humbjes së dëftesës mund të lëshohet një dëftesë zëvendësuese brenda 10 viteve. Kjo dëftesë është me pagesë. Dokumentacioni mbi rezultatet e tërësishme mbahet 10 vite dhe pastaj asgjësohet konform rregullave.
- 1.9 Telefona mobil apo pajisje të tjera të përshtatshme për inxhizim, ruajtje apo transmetim të çfare do lloji nuk lejohet që të merren me vete në provim. Gjate pauzave gjithashtu është e ndaluar të përdoren pajisje teknike. Në rast të mosrespektimit të këtij rregulli, pason përjashtimi nga provimi si dhe një ndalim mbarëbotëror në kohëzgjatje prej 12 muajve. Një padi penale për arsyeje të mashtrimit mund të merret në konsideratë.

2. Paraqitja e provimit

- 2.1 Termini për paraqitje të provimit mund të merret vetëm online. Paraqitja e provimit është e mundur të bëhet vetëm personalisht në Zyrën për Provime. Për paraqitje të provimit mund të paraqitet vetëm personi, i cili parashtron vërtetimin elektronik të terminit për paraqitje. Formularët për paraqitje të provimit duhet të plotësohen me shkronja të mëdha latine nga kandidati i provimit. Goethe-Zentrum Prishtina nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për formular të plotësuar gabimisht
- 2.1.1 Në rast se formulari për regjistrim plotësohet me të dhëna të gabura dhe/ose të pasakta personale, atëherë nuk do të ofrohet mundësia për një vend në provim. Pagesa e bërë për provim do të kthehet, duke i zbritur 40 Euro për punët administrative.

www.goethe.de



- 2.1.2 Nëse pjesëmarrësi/ja i/e provimit nuk shfaqet në datën e rezervuar për paraqitje të provimit, humb e drejta për vendin e provimit për datën e dëshiruar. Shuma e paguar për provim nuk do të kthehet.
- 2.2 Transferi i pagesës për provim i bëhet Goethe-Zentrum Prishtina duke i përcjell të dhënat për emrin e pjesëmarrësit/pjesëmarrëses në provim si dhe të dhënat për provimin.
- 2.3 Të drejtën për pjesëmarrje në provim e kane vetëm pjesëmarrësit e provimit, të cilët e kanë bërë paraqitjen e provimit sipas afateve dhe mënyrës së përcaktuar. Paraqitja e provimit mund të merret në konsideratë, nëse ka mjaftueshëm vende në terminin e përzgjedhur.

3. Rezultatet dhe Dëftesat

- 3.1 Me numrin pjesëmarrës të provimit, pjesëmarrësit e provimit mund të marrin rezultatet e tyre në Internet. Goethe-Zentrum Prishtina nuk ofron ndonjë informacion telefonik për rezultatet.
- 3.2 Pjesëmarrësit në provime që kanë kaluar provimin do të marrin dëftesën e tyre në Zyrën e Provimit të Goethe-Zentrum Prishtina, të lëshuar nga Goethe-Institut Skopje.
- 3.3 Dëftesa lëshohet sipas të dhënave gjate paraqitjes së provimit. Pas lëshimit të dëftesës nuk mund të bëhen me ndryshime në të dhëna.
- 3.4 Dëftesave modulare nuk mund të i lëshohen si zëvendësim apo plotësim dëftesa të plota.

Informata:

Me shumë informata rreth paraqitjes së provimit mund të gjenden në rubrikën „Kosovo-Prüfungen“ në <http://www.goethe-ks.org/haus/menu/pruefungen/goethe-institut/>

www.goethe.de

Goethe-Zentrum mban të drejtën për ndryshime.
Gjendja: prill 2018